



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1667 Prot.

Tiranë, më 06/06/2024

VENDIM QARKULLUES
Nr. 90, datë 06.06.2024

PËR

**“NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR
AUTORITETET, ORGANET DREJTUESE DHE KOMISIONET E PERHERSHME NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të nenit 3, pika 4 dhe nenit 38, pika 1, shkronja “d” të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 26, pika 1, shkronja “s” të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; të nenit 34, pika 6, shkronja “g”, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr. 36, datë 29.03.2024, si dhe të shkresës së KIZ të UMT nr. 36/1 prot., datë 05.06.2024, Senati Akademik, në mënyrë qarkulluese,

VENDOSI:

1. Në Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, në nenin 34, pika 6, shkronja “g” ndryshon si më poshtë:

“Çdo fletë votimi vulozet, në pjesën e pasme të saj me vulën e KZF-së dhe KQV-së. Në rastin kur procesi i votimit në njësinë kryesore do të zhvillohet vetëm në një qendër votimi dhe detyrat e komisionit të qendrës së votimit kryhen prej KZF-së, çdo fletë votimi vulozet në pjesën e pasme të saj, me vulën e KZF-së dhe të Kryetarit të KZF-së.”

2. Ky vendim i përcillet për njohje dhe zbatim njëjësive kryesore dhe strukturave zgjedhore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së dhe njëjësive kryesore të UMT-së.

**KRYETARI
ARBEN GIATA**